



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 505 Prot.

Tiranë, më 08/02/2024

**Lënda:** Kërkesë për marrjen e masës disiplinore.

**Drejtuar:** Znj. Lindita NIKOLLA

**KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

**Baza Ligjore:** *Neni 63, pika 1 gërma d), dhe neni 65/1 pika 1 gërma a) dhe pika 6 dhe 7, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të ndryshuar. Neni 3, gërma dh) dhe ë), neni 6, nenin 8, pika 2 gërma b) dhe neni 33 i Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.*

*E nderuar zonja Kryetare,*

Në seancën plenare të datës 08.02.2024 u gjendëm përsëri përballë kaosit dhe bllokimit nga deputetët e opozitës.

Kjo situatë aspak normale u krijua që në nisje të seancës ku deputetë të caktuar të opozitës tentuan me forcë që të kalonin kordonin e punonjësve të gardës duke i shtyrë ata, ofenduan me ijalë të rënda anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe Kryetaren e Kuvendit si dhe ndezën disa pajisje zhurmuese që krijuan kaos në sallë duke penguar zhvillimin e rregullt të seancës plenare, veprime këto të dënueshme në Rregulloren e Kuvendit dhe në Kodin e Sjelljes së Deputetit.

Deputeti Petrit Doda sapo nisi seanca plenare u konfrontua me punonjësit e gardës pasi tentoi të kalonte kordonin e gardës, si dhe i'u drejtua me tone të larta dhe me fjalë të rënda fyese anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe drejtueses së seancës.

Deputeti Edi Paloka ndezi paisjen zhurmuese duke krijuar kaos dhe zhurmë në sallë. Gjithashtu deputeti Paloka i vendosi flakën Rregullores së Kuvendit dhe më pas e hodhi në drejtim të anëtarëve të Këshillit të Ministrave, duke rrezikuar kështu zjarrvënien në sallë.

Rregulli dhe zhvillimi i seancës parlamentare sipas rendit të ditës të miratuar, u pengua dhe u cënuar nga sjelljet agresive dhe kaosi i krijuar nga deputetët e opozitës. Gjendur përballë kësaj situatë aspak normale, Kryetarja e Kuvendit u detyrua të kalonte menjëherë në procesin e votimit.

Nisur nga këto sjellje bllokuese të veprimtarisë parlamentare nga deputetët e opozitës, në mbështetje dhe të Rregullores së Kuvendit; neni 63, pika 1 gërma d), dhe neni 65/1 pika 1 gërma a) dhe pika 6 dhe 7, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe në mbështetje të nenit 3, gërma dh) dhe ë), neni 6, nenin 8, pika 2 gërma b) dhe nenin 33 të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, paraqesim kërkesën si më poshtë:

- Marrjen e masës disiplinore ndaj deputetëve Edi Paloka dhe Petrit Doda, sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

- Mbledhjen e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën për vlerësimin e masës disiplinore.

DEPUTETËT :

- 1) Florenc Spaho
- 2) Ilir Pevdani
- 3) Ili Metaj
- 4) DENIS DEZIU
- 5) Edmond Adreca
- 6) Ljiljana Xhaferri
- 7) Beuta Bece
- 8) Tule Krasniqi